

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 7

(Janar– Qershor 2020)

Permbajtja

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	4
1. Vendim nr. 97, datë 20.01.2020	4
2. Vendim nr. 255, datë 07.02.2020	6
3. Vendim nr.615, datë 18.06.2020	7
4. Vendim nr.363, datë 19.02.2020	9
5. Vendim nr. 386, datë 20.02.2020	12
6. Vendim nr. 15, datë 17.01.2020	15
7. Vendim nr. 129, datë 29.01.2020	17
8. Vendim nr. 617, datë 18.06.2020	19
9. Vendim nr. 263, datë 12.2.2020	21
10. Vendim nr. 3352, datë 23.12.2019	23
11. Vendim nr. 146 date 29.01.2020	26

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në faqen legjislacionin, në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr. 97, datë 20.01.2020

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Administrative

Padites: “A.J” person fizik, me NIPT____

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizimi i akteve administrative Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.____prot, datë 16.08.2019
2. Vendimin nr ____ prot, datë 30.09.2019 Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 50,000 lekë

Baza Ligjore:

1. Kodi i procedurave Civile neni 31, 32.
2. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar nenet 7,11,15,17 e vijues.
3. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Permbledhje e Fakteve:

Paditesi A.J ushtron aktivitet tregtar qebabtoze, i regjistruar si person fizik në QKB me nr NIPT____.

Referuar akt-konstatimit nr. ____ datë 24.07.2019 të mbajtur nga inspektorët në sektorin e monitorimit territorial, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor, R.Q, ndaj tatimpaguesit “A.J” person fizik, është ushtruar kontroll në datën 24.07.2019 në zbatim të urdhër-shërbimit me nr. ____ prot, datë 23.07.2019. Gjatë kontrollit në ambientet ku ushtron aktivitet tatimpaguesi është evidentuar se subjekti nuk lëshon kupon tatimor për 10 “qofte” me çmim 30 lekë/qofte dhe 2 “birra” me çmim 50 lekë/birrë. Kontrolli u realizua nga ora 19:52 deri në orën 21:00.

Për moslëshim të kuponit tatimor, tatimpaguesi është dënuar në përputhje me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sipas nenit 122, pika 1, gërma b (i), bazuar në akt-konstatimin e datës 24/07/2019.

Vlerësimi i Gjykates:

Gjykata pas shqyrtimit të provave të administruara në gjykim nga palet ndërgjyqesë vlerësoi së në akt konstatim nuk përshkruhet saktë se si është kryer kundravajtja administrative, pra nuk përcaktohet saktë moment i shërbimit të artikullit dhe moment i lëshimit apo moslëshimit të kuponit tatimor.

Shprehja se ishte shërbyer dhe nuk ishte lëshuar kupon tatimor nuk kualifikohet nga gjykata se shkelja ka ndodhur. Aq me tepër nuk provohet me prova shkelja e kryer. Pra, pala e paditur ka vendosur një gjobë për moslëshim kuponi tatimor por nuk identifikon momentin e shkeljes së kryer, kur duhet të përshkruajë kohën e plotë në orë dhe minuta të kryerjes së shkeljes, nisur edhe nga fakti se pajisja fiskale përcakton në kuponin tatimor, në mënyrë të saktë orën dhe minutën e lëshimit të kuponit.

Në rastin konkret, akt konstatimi i pales se paditur thjesht përshkruan se në harkun kohor 19:52-21:00 nuk është lëshuar kupon tatimor.

Në këto kushte në aktet procedural të mbajtur nga pala e paditur nuk provohet koha e saktë e kryerjes së shkeljes, duke bërë që të mos identifikohet veprimi i shkeljes konkrete dhe aplikimin e gjobës në rastin konkret.

Vendim:

- Pranimin e padisë, shfuqizim i aktit administrativ.

2. Vendim nr. 255, datë 07.02.2020

Gjykata Administrative e Apelit

Padites: A.K

I paditur: 1. Drejtoria e Apelimit Tatimor

2. Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Objekti:

1. Anullim/shfuqizim pjesërisht i vendimit nr. ____, datë 07.11.2016 të Drejtorisë së Apeliti Tatimor.
2. Anullim dhe shfuqizim te njoftim vleresimit për detyrimet tatimore nr. ____, datë 9.08.2016 i Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve si të paligjshëm.

Shuma e detyrimit tatimor: 1.185.156 leke

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurave Administrative
2. Ligji 49/2012” Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”
3. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Përmbledhje e fakteve:

Tatimpaguesi “A.K”, i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit. Shoqëria ka apeluar pranë Drejtorisë të Apelit Tatimor aktin administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore ____ prot, datë 09.08.2016, nxjerrë nga Drejtorinë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj në shumën totale 2.664.993 (kamatvonesa dhe gjoba tatim fitimi).

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin nr. ____, datë 07.11.2016 ka vendosur pjesërisht shfuqizimin e njoftim vlerësimit dhe lënien në fuqi për pjesën tjetër tatim fitim 2013.

Kamatëvonesat dhe gjobat i janë llogaritur shoqërisë nga sistemi tatimor per detyrime t.fitimi të papaguara në afat pasi pagesat dhe kompensimi kanë kaluar për detyrime të tjera në proces ankimi.

Vlerësimi i Gjykates:

Gjykata Administrative e Shkalles se Parë me vendimin nr. 854, datë 06.03.2017 ka vendosur pranimin e padise dhe shfuqizimin e njoftim vlerësimit nr. ____, datë 09.08.2016 të Drejtorinë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ____, nr.07.02.2020 të marrë në dhomë këshillimi pa na dhënë mundësinë të dëgjoheshim në lidhje me ankimin tone, ka vendosur lënien ne fuqi të vendimit të shkallës së pare.

Në arsyetimin e saj gjykata nuk e ka prekur fare themelin e cështjes por është shprehur se akti është absolutisht i pavlefshëm pasi është nxjerrë në kundërshtim me procedurat, është firmosur nga një punonjës i drejtorise rajonale me porosi të drejtorit rajonal në mungesë të delegimit të kompetencave

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë

3. Vendim nr.615, datë 18.06.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: E.S, person fizik tregtar

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr.____ prot., dt.15.06.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
2. Shfuqizimin e Vendimit nr.____ prot., dt.28.09.2015 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shuma e detyrimit tatimor: 500.000 Lekë

BazaLigjore:

1. Nenet 32, 153 të Kodit të Procedurave Civile.
2. Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
3. Ligji nr.9920, dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Përmbledhje e Fakteve:

E.S ushtron aktivitet si Person Fizik Tregtar, në adresën: rruga e “Qelqit”, ndërtesë private pranë Fabrikës së Qelqit, Tiranë, me objekt tregtimin me pakicë të artikujve ushqimore.

Në datë 20.04.2015, ora 12:15, inspektorët e Sektorit të Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, bazuar në Urdhër-Shërbimin nr. ____ prot., dt.20.04.2015, kanë ushtruar kontroll në ambientin e aktivitetit të tatimpaguesit E.S.

U mbajt Akt-konstatimi nr. ____ dt.20.04.2015 në ambientin e ushtrimit të aktivitetit të tatimpaguesit, sipas të cilit në momentin e kontrollit në punë u gjendën 5 persona, ndër të cilët 1 prej tyre rezultoi të ishte i padeklaruar si i punësuar.

Sa më sipër, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, bazuar në të dhënat e evidentuara në akt-konstatimin nr. ____ dt.20.04.2015, ka nxjerrë Njoftim Vlerësimin nr. __ prot., datë.15.06.2015 sipas të cilit tatimpaguesi E.S, detyrohet të paguaja gjobë në shumën 500.000 lekë, për mosdeklarim punonjësi.

Njoftim Vlerësimin e sipërcituar, subjekti e ka ankimuar pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. ____, datë 28.09.2015 ka vendosur lënien në fuqi të Njoftim Vlerësimin.

Duke mos qenë dakord për sa më sipër, tatimpaguesi E.S e ka bërë çeshtjen konflikt gjyqësor, duke kërkuar nëpërmjet kërkesë padisë së saj, shfuqizimin e Njoftim Vlerësimin nr. __ prot., dt.15.06.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe të Vendimit nr. ____ dt.28.09.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.1829, datë18.04.2016 ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesë-padisë së palës paditëse E.S.

2. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. __ prot., datë 15.06.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Vendimit nr. __ prot., dt.28.09.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata Administrative e Apelit, çmon se Gjykata e Shkallës së Parë, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për t’u zbatuar në funksion të zgjidhjes së drejtë të saj, por duke i interpretuar ato në mënyrë jo korrekte.

Gjykata e Apelit Administrativ, përkundër përfundimit të Gjykatës së Shkallës së Parë vlerëson se, administrata tatimore ka kryer në këtë rast hetim të plotë, për sa kohë ka identifikuar:

- Datën dhe orën e kontrollit, 20.04.2015 ora 12:15;

- Tatimpaguesin, E.S, person fizik tregtar;

- Personat e pranishëm në momentin e kontrollit, pesë persona përfshirë dhe paditësen, duke pasqyruar të dhëna personale për secilin prej tyre.

Deklarimin e punonjësit ____ në organet tatimore, në datë 20.04.2015, ditën e kontrollit.

“Vlerësimi tatimor në shumën 500.000 Lekë, sipas Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. ____ prot., datë.15.06.2015 është rrjedhojë e Akt-Konstatimit me nr. ____, datë.20.04.2015, mbajtur nga inspektorët e Hetimit Tatimor, Rajoni Qendror pranë DRT Tiranë. Në zbatim të Ligjit nr.9920, dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Neni 68 “Vlerësimi Tatimor” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.24 dt.02.09.2008, administratës tatimore i jepet e drejta e kryerjes së vlerësimin të detyrimit tatimor i cili bazohet në informacionet që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit, rezultatet e kontrollit apo mënyrat alternative të vlerësimin.

Në rastin konkret, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka disponuar të dhëna të vëna në dispozicion me shkresën nr. ___ prot., datë 21.04.2015 të Drejtorinë e Hetimit Tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për verifikime të mëtejshme lidhur me punonjësit e konstatuar. Në vijim të Akt-Konstatimit të datës 20.04.2015, në zbatim të detyrave të lëna, është kryer verifikimi në sistemin informatik tatimor c@ts (i listëpagesave si dhe E-SIG027) i deklarimeve të bëra nga subjekti, rezultoi se z. ____, sipas listëpagesave të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin Mars 2015 nuk ishte i deklaruar.

Referuar datës së konstatimit, mosdeklarimi i të punësuarve në organin tatimor të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës përbën shkelje tatimore administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 119 të Ligjit nr. 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Vendim:

1. Ndryshimin e Vendimit nr.1829, dt.18.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
3. Rëzimin e kërkesë padisë.

4. Vendim nr.363, datë 19.02.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqeria "Y" sh.p.k

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.
2. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane.

Objekti:

1. Kundërshtimin dhe shfuqizimin e Aktit nr. ___, datë 06.05.2015 "Njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor" të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.
2. Kundërshtimin dhe shfuqizimin e aktit nr. ___ Prot, datë 18.08.2016 "Vendim" të Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore:

Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. __ prot., datë 06.05.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë për gjobën në shumën totale 1 000 000 lekë.

Baza Ligjore:

1. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”nenet 7, 11, 15, 17, 18 e vijues
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 106.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Pranë palës paditëse kanë ushtruar kontroll inspektorët e kontrollit tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë në bazë të urdhrit të punës me datë 07.09.2015 i cili midis të tjerave kishte në objekt kontrolli edhe punonjësit e siguruar ose jo në momentin e kontrollit që gjenden në subjekt.

Nga akt konstatimi i datës 17.09.2015 që është mbajtur pranë subjektit tatimor janë shënuar në pikën 4 të tij personat që janë gjetur në objekt dhe në këtë listë janë shënuar me nr.rendor 85 shtetasja ___ ndërsa me nr.rendor 105 është shënuar shtetësja___. Ky akt kontrolli është firmosur rregullisht nga përfaqësuesi i shoqërisëm “Z”.

Sipas Akt Vleresimit të mbajtur në datë 22.12.2015, rezulton se referuar akt konstatimit të mbajtur nga Inspektorët e Verifikimit në Terren me datë 17.09.2015, për subjektin “Y” sh.p.k, rezulton se në momentin e kontrollit janë gjetur në punë 119 punonjes nga këta dy punonjes konkretisht ___ i dhe _____ nuk janë deklaruar në listëpagesën e muajit shtator 2015, bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008 subjekti është penalizuar për mosdeklarim punonjësi me gjobë në masën 500,000 lekë për secilin prej tyre.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë nepermjet aktit "Njoftim vleresimi per detyrimet" nr 2741, date 06.05.2016 ka njoftuar subjektin, tatimpaguesin “Y” sh.p.k për detyrimet që ka papaguar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë deri me date 29.12.2015 gjobe ne masen 1 000 000leke.

Pala paditëse duke mos qene dakort me penalizimin e mesiperm të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë si dhe duke mos qene dakort me rezultatet e dala ne kete Njoftim Vleresimi Tatimor, ne perputhje me nenin 106 te ligjit 9920 date 19.05.2008 ka ushtruar ankim administrativ, datë 20.05.2016 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim kerkesen ankimore të subjektit tatim pagues, në përfundim të shqyrtimit administrativ, me Vendimin nr. 16795/2 prot., datë 18.08.2016 ka vendosur: *"Lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 1.000.000 leke percaktuar ne aktin administrativ Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore, nr.2741, date 06.05.2015 te Drejtorisë Rajonale Tatimore, Gjirokaster, për mosdeklarim të dy punonjesve ne organin tatimor".*

Arsyetimi ligjor i gjykatës:

Kolegji Administrativ i Apelit, në analizë të shkakut dhe kërkimit objekt padie, pretendimeve të palëve dhe provave shkresore të lejuara për shqyrtim në lidhje me këtë mosmarrëveshje, çmon se vendimi nr.679 date 02.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Gjirokastrë është marre

ne zbatim dhe interpretim të gabuar të provave dhe dispozitave të aplikueshme në rastin konkret, si i tillë ai duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet me arsyetimin si më poshtë vijon:

Kolegji Administrativ i Apelit ne analizë të rrethana të çështjes arrin në konkluzionin se gjykata ka interpretuar në mënyrë të gabuar faktet dhe rrethanat në raport me ligjin. Ndryshe nga sa arsyeton gjykata ne vendimin objekt ankimi, rezulton plotësisht e provuar se aktet administrative objekt i shqyrtimit gjyqësor, janë nxjerrë në përputhje me ligjin nr.9920/2008 dhe udhëzimin nr. 24, të Ministrit të Financave date 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Detyrimi tatimor gjorbë në masën 1.000.000 leke është rezultat i kontrollit të kryer pranë pales së paditur në ambientet ku ajo ushtron aktivitetin e saj, në prezence te perfaqesuesit të saj z.____. Nga akt konstatimi i cili është firmosur rregullisht prej inspektoreve tatimor dhe perfaqesuesit të shoqërisë janë identifikuar punonjesit e gjendur ne pune ne ate moment ne ambientet e punes se pales paditese/subjektit tatimpagues, e nga ka rezultuar se në punë ishin edhe dy shtetaset ____ dhe ____.

Më tej nga ana e inspektorëve jane kryer verifikimet e punonjësve të gjendur në pune dhe listëpagesat e kryera nga shoqëria për muajin e kontrolluar, dhe ka rezultuar nga listëagesa e muajit shtator se ato nuk figurojne, por ne te kundert, nga paditesi ato ishin deklaruar per organin tatimor si te larguara nga puna qe nga Muaji Gusht 2015, nëpermjet E – SIG 027 "Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna", Nr. 172, date 04.08.2015 dhe Nr. 173, datë 24.08.2015. Për sa më sipër, rezulton se paditësi është në shkelje të nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008 i ndryshuar dhe me të drejtë ndaj tij është vendosur detyrimi gjorbë në masën 1.000.000lekë.

Në përfundim, Kolegji konkludon se aktet administrative objekt gjykimi janë të ligjshme për pasojë ato duhet të lihen në fuqi ndërsa padia duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova e në ligj.

Vendimi i gjykatës:

1. Ndryshimin e vendimit nr.679, datë 02.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.
2. Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj prova.

5. Vendim nr. 386, datë 20.02.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “XX” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti:

1. Shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. ____ datë 29.06.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ datë 14.09.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore:

Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë 29.06.2016 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për gjobën në vlerën 500,000 lekë.

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurave Administrative, nenet 115 e vijues
2. Kodi I Procedurës Civile, nent 31, 153, 154.
3. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
4. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikës Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9136 datë 11.06.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore”, i ndryshuar,
6. VKM nr.77 datë 28.01.2015 “Për Kontributet e Detyrueshme dhe Përfitimet nga Sistemi i Sigurimeve dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar.
7. Udhëzimi nr.23 datë 09.12.2014 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore”.

Përmbledhje e fakteve:

Tatimpaguesi “XX”, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesëpadinë me objekt: Shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.____, datë 29.06.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.____, datë 14.09.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, për gjobën në shumën 500.000 lekë për punonjës të padeklaruar.

Ky njoftim vlerësimi është nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë bazuar në aktin e konstatimit nr.serie ____ datë 24.06.2016, ku pas një verifikimi në vend të kryer nga inspektorët e

Verifikimit në Terren pranë Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, është konstatuar se ky tatimpagues punonjësin z.____, i cili u gjet në punë në momentin e kontrollit, nuk e kishte deklaruar në organin tatimor, sipas dispozitave ligjore.

Referuar kësaj shkeljeje administrative të kryer, nga grupi i kontrollit u mbajt procesverbali i gjobës nr.0209448 datë 24.06.2016 nëpërmjet të cilit tatimpaguesi “XX” sh.p.k, u penalizua me gjobë në shumën 500,000 lekë, për punonjësin e padeklaruar në organin tatimor, në zbatim të nenit 119 pika 1 gërma/a të Ligjit nr.9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në vijim Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë ka nxjerrë aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot, datë 29.06.2016 për gjobën në shumën 500,000 lekë.

Tatimpaguesi “XX” sh.p.k, ka ankimuar në Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë Njoftim Vlerësimin e nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, e cila pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr.____ prot datë 14.09.2016, ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot datë 29.06.2016, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë dhe rrëzimin e ankimit..*

Më pas kjo shoqëri ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrativë NjoftimVlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot datë 29.06.2016 dhe Vendimit nr. ____prot datë 14.09.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër me vendimin e saj nr.695 datë 10.11.2016 ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Anullimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.____ prot datë 29.06.2016 të palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, i lënë në fuqi me vendimin nr.____ dt 14.09.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative dhe me vendimin e saj nr.386 datë 20.02.2020 ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Kjo gjykatë ka vlerësuar se ankimi i palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë përmban shkaqe ligjore që motivojnë cënimin e vendimit nr.695 datë 10.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër si vendim i dhënë në zbatim të gabuar të ligjit.

Ndaj palës paditëse shoqërisë “XX” sh.p.k, Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë ka vendosur dënimin me gjobë bazuar në aktin e konstatimit të datës 24.06.2016, përpiluar nga inspektorët e verifikimit në terren të Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë si dhe nga verifikimi i listëpagesave dhe formularët E-Sig 027 të palës paditëse në sistemin elektronik C@ts. Sipas këtij verifikimi provohet se paditësi të ketë deklaruar marrjen në punë të punonjësit ____ në datë 03.07.2016.

Akti i konstatimit rezulton të jetë nënshkruar nga grupi i kontrollit si dhe i nënshkruar pa asnjë vërejtje nga shtetasi _____. Në vlerësimin e gjykatës çmohet e provuar se gjendja e konstatuar është pasqyruar

korrektësisht në aktin e konstatimit nga ana e inspektorëve tatimor të verifikimit të palës të paditur. Veprimtaria e kontrollit rezulton në përputhje me nenin 80 të Ligjit 9920/2008 dhe pikës 80.3 të Udhëzimit nr.24/2008, i cili detajon verifikimin në vend si formë kontrolli.

Në vendin e ushtrimit të aktivitetit të palës paditëse me vendodhje në Borsh, Sarandë, në ditën e kontrollit 24.06.2016 inspektorët kanë dokumentuar se shtetasi ____, me banim në Tiranë është gjetur në punë. Në vijim provohet se i punësuar _____ nuk është deklaruar nga paditësi sikurse parashikon ligji, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës. Rezulton se paditësi ka bërë një deklaram të tillë për punësimin e këtij personi me datë fillimi datën 03.07.2016, tetë ditë pasi është kryer kontrolli.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi nuk ka përmbushur detyrimin si tatimpagues punëdhënës për të deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës. Pretendimi i paditësit se në momentin e kontrollit që është konstatuar prezenca e z.____ në subjekt, ai nuk ka qenë duke punuar, vlerësohet i papranueshëm dhe i pabazuar në ligj. Akti i konstatimit për gjetjen e tij në punë në vendin e ushtrimit të aktivitetit nga pala paditëse dokumenton konform ligjit gjendjen e konstatuar dhe nuk është vënë në diskutim për përmbajtjen e tij, ai është nënshkruar nga punonjësi i palës paditëse pa vërejtje.

Gjykata vlerëson se rrethanat e pretenduara nga paditësi nuk referohen në asnjë nga situatat përjashtuese të përcaktuara nga neni 111 pika 4 e Ligjit 9920/2008.

Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se vendimi nr.695 datë 10.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër për shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.____ prot datë 29.06.2016 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit në faktet dhe rrethanat e provuara gjyqësisht.

Veprimtaria e palës së paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë është ushtruar në respektim të kërkesave të legjislacionit tatimor, duke evidentuar e faktuar ne korrektësi shkeljen e kryer nga paditësi “mosdeklarimin e punonjësit”, ndaj me të drejtë penalteti është lënë në fuqi me vendimin nr.____ datë 14.09.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Vendimi i Gjykatës:

- 1. Ndryshimin e vendimit nr.695 datë 10.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër.*
- 2. Rrëzimin e kërkesë padisë.*

6. Vendim nr. 15, datë 17.01.2020

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë

Paditës: Subjekti “G.S” sh.p.k,

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë

2. Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

Objekti: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.____, datë 21.08.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, i lënë në fuqi me vendimin nr.____ datë 01.11.2019 nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore: Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë 21.08.2019 i nxjerrë nga DRT Sarandë për gjobën në vlerën 50,000 lekë.

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurës Civile, nent 17, 32, 153,154
2. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” neni 109
3. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 106.

Përmbledhje e fakteve:

Subjekti “G.S” sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt: Anullimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.____ datë 21.08.2019 për pagesën e gjobës 50.000 lekë, i lënë në fuqi me vendimin nr.____ prot datë 01.11.2019 nga Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë.

Ky njoftim vlerësimi është nxjerrë nga Drejtoria e Rajonale Tatimore Sarandë bazuar në aktin e konstatimit nr. serie ____ datë 17.08.2020, ku pas një verifikimi në vend të kryer nga inspektorët e zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni Qëndror në ambientin ku shtron aktivitetin pala paditëse, ka rezultuar se ky subjekt në momentin e kontrollit nuk kishte lëshuar kuponin tatimor në një tavolinë për shërbimin e kryer një sallatë jeshile me vlerë 300 lekë dhe për një midhje me vlerë 500 lekë, sipas përcaktimeve ligjore.

Referuar kësaj shkeljeje administrative të kryer, nga grupi i kontrollit u mbajt procesverbali i gjobës nr.____ datë 17.08.2019 nëpërmjet të cilit tatimpaguesi “G.S” sh.p.k, u penalizua me gjobë në shumën 50,000 lekë, për moslëshim të kuponit tatimor, në zbatim të nenit 122 pika 1 gërma b(i) të Ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Në vijim DRT Sarandë ka nxjerrë aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ___ prot datë 21.08.2019, për gjobën në shumën 50,000 lekë.

Tatimpaguesi “G.S” sh.p.k, ka ankimuar në Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë Njoftim Vlerësimin e nxjerrë nga Drejtoria e Rajonale Tatimore Sarandë, e cila pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr. ___ prot datë 01.11.2019, ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ___ prot datë 21.08.2019, nxjerrë nga DRT Sarandë, gjobë për moslëshim kuponi tatimor në shumën 50.000 lekë, nxjerrë nga DRT Sarandë.*

Më pas kjo shoqëri ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar anulimin e akteve administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ___ prot datë 21.08.2019 të nxjerrë nga Drejtoria e Rajonale Tatimore Sarandë dhe Vendimit nr. ___ prot datë 01.11.2019 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka vlerësuar se Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. ___ prot datë 21.08.2019 i nxjerrë nga Rejtoria Rajonale Tatimore Sarandë si dhe vendimi nr. ___ prot datë 01.11.2019 i Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë janë veprime administrative në kundërshtim me ligjin material.

Në seancë gjyqësore pala e paditur nuk provoi se pala paditëse ka kryer kundravajtjen administrative të parashikuar nga neni 122 të Ligjit 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me aktin e konstatimit të mbajtur paditësi nuk ka qënë dakort dhe e ka kundërshtuar me pretendimin se kuponi ishte prerë dhe ishte mbi banak.

Sipas përmbajtjes së proçesverbalit të mësipërm provohet se subjekti paditës e ka prerë kuponin tatimor për këtë kupon nuk e ka vendosur në tavolinën e porositur.

Gjykata çmon se qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet dispozitës ligjore ka qënë dhe është prerja e kuponit tatimor, për çdo shitje të kryer. Ligjvënësi nuk e ka parashikuar si kundravajtje administrative mosvendosjen e kuponit tatimor në tavolinën e porositësit.

Gjykata çmon se pala paditëse nuk ka kryer asnjë veprim e mosveprim me faj në kundërshtim me nenet 122 të Ligjit 9920/2008 dhe për rrjedhojë proçesverbali i gjobës i datës 17.08.2019, nëpërmjet të cilit paditësi është ndëshkuar me gjobë në shumën 50.000 lekë, është marrë në kundërshtim me ligjin 9920/2008 dhe ligjin ‘Për Kundravajtjet Administrative’ dhe për këto arsye përbën akt të paligjshëm, pasojat juridike të të cilit duhen anuluar në kuptim të nenit 109/dh të Kodi I Procedurave Administrative.

Gjykata çmon se dhe akti administrative i organit epror që ka lënë në fuqi aktin administrative objekt shqyrtimi gjyqësor është i paligjshëm në kuptim të nenit 109/dh të K.Pr.Administrative.

Vendimi i Gjykatës:

1. Pranimin e kërkesë padisë.
2. Shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ datë 21.08.2019 të DRT Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr.____ prot datë 01.11.2019 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

7. Vendim nr. 129, datë 29.01.2020

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: Shoqëria tregtare “C.D” shpk.

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

2. Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

Objekti:

1. Anullimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. ____ Prot, datë 03.10.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.
2. Anullimin e aktit administrative Vendim nr.____ Prot datë 29.12.2015, i Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: 500.000 lekë

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurës Administrative
2. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” neni 7, 15, 17
3. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
4. Ligji nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, nenet 30, 109, 119 e vijues
5. Udhëzimi Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

Përmbledhje e Fakteve:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me Vendimin Nr.267, datë 29.03.2016 ka vendosur “Pranimin e Padisë”. Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me pretendimet se pas kryerjes së një verifikimi në terren nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës sipas të cilit është konstatuar se Marcela Gjini nuk është e përfshirë në listëpagesën e shoqërisë “C.D”shpk, është hartuar procesverbal giobe nr.____, datë 25.09.2015. Bazuar

ne nenin 119, pika 1 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës ka vendosur gjobën për mosdeklarim të punonjësit në shumën prej 500.000 lekë dhe ka nxjënë Njoftim Vlerëshmin Tatimor përkatës, nr. ____ Prot datë 03.10.2015.

Referuar legjislacionit tatimor, mos deklarimi në organin tatimor të punonjësve, përbën, shkelje tatimore administrative, dhe dënohet me gjobë, në zbatim të Ligit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku neni 119 i tij përcakton se: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi, nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:- Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin dhe TVSH, ne shumën prej 500.000 lekesh.

Vlerësimi i Gjykatës:

Shoqëria tregtare “C.D” shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, me numër identifikimi NIPT ____. Kjo shoqëri zhvillon veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve telefonike për të tretë, në veçanti shitje telefonike, telemarketing, hetime dhe kërkime tregu, kujdes ndaj klientit, konsulencë ndihmese telefonike dhe gjithçka tjetër, në shërbim të konsumatorit final. Shoqëria paditëse në kuadër të aktivitetit të saj, ka lidhur me subjektin “F.S”, (person fizik i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L31713503S), një kontratë shërbimi. Referuar nenit 1, pika 1, “Shërbimi i Receptonit dhe Sigurisë”, objekti i kësaj kontrate është midis të tjerash edhe shërbimi i vënies në dispozicion të personelit të tatimpaguesit “F.S” për paditësin, për të ofruar shërbimin e receptonit. Bazuar në këtë kontratë subjekti F.S ka vënë në dispozicion të pales paditëse, punëmarrësen e tij shtetasen _____. Rezulton se, midis _____, në cilësinë e punëmarrëses dhe subjektit F.S, në cilësinë e punëdhënësit, është lidhur në datën 30.10.2014, Kontrata e Punës individuale me një afat 12 mujor. Në bazë të këtyre kontratave, punëmarrësja _____ do të ushtrojë detyrën e saj, pranë zyrave të Shoqërisë “C.D”, duke ofruar shërbimin e receptonit. Subjekti F.S, ka bërë deklarinimin e paditëses, për _____. Deklarimi është i datës 01.11.2014. Me anë të tij, F.S ka deklaruar pranë administratës tatimore se znj. _____ është punonjëse e tij. Deklarimi është dhe në listë pagesën e muajit Gusht 2015.

Gjykata Vlerëson se vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, është i drejtë, pasi sikurse më të drejtë ka konkluduar gjykata e shkallës së parë dhe në të kundërt sa pretendon pala e paditur, nga provat shkresore të administruara gjatë gjykimit, ka rezultuar e provuar se punonjësja e gjetur gjatë kontrollit të ushtuar nga pala e paditur, vërtetë nuk është deklaruar nga pala paditëse si e punësuar prej saj, por nga aktet shkresore, provohet plotësisht se ajo është e punësuar tek subjekti, Person fizik F.S i cili e ka deklaruar rregullisht për efekt sigurimesh shoqërore, dhe se ky person kryen shërbimin e receptonistës, pranë pales paditëse në bazë dhe për zbatim të kontratës së shërbimit, që pala paditëse ka më subjektin F.S. Në zbatim të kësaj kontrate provohet se pala

paditese i ku paguar, personit fizik për shërbimin e ofruar çmimin e kontratës nëpërmjet faturave të rregullta tatimore.

Vendim:

1. Lënien në Fuqi të Vendimit Nr.267, datë 29.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

8. Vendim nr. 617, datë 18.06.2020

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: Shoqëria “E.A” shpk,

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës.

2. Drejtoria e Apelimit Tatimor, Tiranë.

Objekti:

1. Shfuqizimin e Aktit Administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet nr. ____ prot, datë. 03.11.2015, të Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës dhe vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr. ____ Prot Dt.10.02.2016

Shuma e detyrimit tatimor: 500.000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurës Administrative”
2. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” neni 7, 15, 17
3. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,i ndryshuar

Përmbledhje e Fakteve:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin 528 datë 09.06.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim Shoqëria “E.A” shpk, me argumentet se në datën 03.10.2013 nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës është nxjerrë akti administrative Njoftim Vlerësimi për Detyrimet, sipas të cilit është penalizuar paditësi me shumën 500.000 lekë, me pretendimin se gjatë kontrollit rezultoi mosdeklarimi i një punonjësi për periudhën 2015/09.

Konstatimi i inspektoreve, është i pasaktë, pasi siç e kemi bërë të qartë edhe në ankesën tonë pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, z.____, që është personi që është konstatuar si i papunësuar nga organet tatimore, është ortak i shoqërisë sonë, me 17 % të aksionve të saj. Ky fakt është pranuar edhe nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, pasi nga ana jonë ju është vënë në dispozicion ekstrakti historik i shoqërisë, megjithatë kjo drejtori ka vendosur lënien në fuqi të Aktit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, me arsyetimin se ortaku i shoqërisë është gjetur në punë.

Së dyti, pretendimi se z.____, duhet të ishte i punësuar dhe i deklaruar pranë organeve tatimore, është allogjik dhe i padrejtë, pasi zotëria në fjalë, prej vitesh ka mbushur moshën e pensionit dhe paguhet si i tillë, pasi ka kontribuar për vite me rradhë si tatimpagues dhe si i siguruar pranë sigurimeve shoqërore. Në të tilla kushte, z.____, as mund të lidhte kontrate pune me kompaninë tone dhe as mund të sigurohet si i tillë, e të deklarohet pranë Organeve Tatimore. Edhe gjykata administrative Durrës, ka gabuar në arsyetimin e saj, pasi ____ nuk është punonjës i shoqërisë, por një ndër aksionerët e saj.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, bazuar në të dhënat e evidentuara në Akt-Konstatimin Nr.____ serie datë.23.10.2015, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, rezulton të ketë disponuar njoftim vlerësimin nr.____ prot., datë 03.11.2015, që konsiston në ndërkimimin e tatimpaguesit "E.A" sh.p.k me 500.000 lekë gjobë, për mosdeklarim prej tij të një punonjësi ____, rrjedhimisht shmangies nga detyrimi i derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Gjykata e Apelit Administrativ çmon se, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të Nenit 17/2 të Ligiit Nr.49/2012, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje. Përkundër përfundimeve të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, Akt-Konstatimi nr.____ serie datë 30.07.2015, nuk është nënshkruar nga ortaku ____, por nga administratori i shoqërisë, shtetasi _____. Në këtë kontekst, nuk ka arsye të vihet në diskutim fakti, nëse ortaku ____ i ka ushtruar, ose jo kompetencat e administratorit të shoqërisë, përderisa ato konfirmohet të jenë ushtruar nga personi që mban cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë, pra nga administrator _____. Në vlerësimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, mosushtrimi nga shtetasi/pronari ____, i funksioneve drejtuese në shoqëri, përbën rrethanë të mjaftueshme për përjashtimin e shoqërisë nga detyrimi i deklarimit të këtij personi, në listën e personave të punësuar, e si të tillë, të detyrueshëm për të qenë të siguruar. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit Administrativ, e konsideron të papërligjur përfundimin e gjykatës së shkallës së parë.

Vendim:

1. Ndryshimin e Vendimit Nr.528, datë 09.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
2. Pranimin e kërkesë padisë.

9. Vendim nr. 263, datë 12.2.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “B” sh.p.k

I Paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Berat
2. Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve, Komisioni i Shqyrtimit të Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizim i pjesshem i Njoftim-Vlersimit për Detyrimet Tatimore nr. ___ prot. datë 25.05.2018 dhe Njoftim-Vlersimit për Detyrimet Tatimore nr. ____, prot.datë 28.05.2018 i Drejtoria Rajonale Tatimore Berat
2. Shfuqizimi i vendimit nr. ___, datë 27.08.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor

Baza Ligjre

1. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërise;
2. Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin mbi te Ardhurat“;
3. Ligji nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar“;
4. Ligji nr.7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar“;
5. Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
6. Vendimi Nr.781,date 14.11.2007, i ndryshuar si dhe udhezimi nr.16, date 03.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave te paisjes fiskale“;
7. Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare“ i ndryshuar me ;
8. Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë“
9. Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë“

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqeria “B” shpk me Nipt ___ i është drejtuar Gjykatës Administrative ne lidhje me kundërshtimin e njoftim vlersimeve nr. ___, prot. datë 25.05.2018 dhe nr. ___, prot. datë 28.05.2018, te dala nga kontrolli i ushtruar ne kete subjekt, qellimi I te cilit eshte për saktësimin e rezultatit financiar e fiskal të deklaruar nga shoqëria.

Në baze te programit te kontrollit,objekti i kontrollit është:

- Kontrolli për Tvsh-ne: Qershor 2016 – Janar 2018.

- Kontrolli për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore për periudhën Qershor 2016 – Janar 2018.
- Kontrolli për Tatim fitimin Viti 2015, viti 2016.
- Kontroll mbi zbatimin e Ligjit Nr.92/2014, date 24.07.2014 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne Republiken e Shqiperise”, si dhe Udhezimit te Ministrit te Financave, Nr.6, date 30.01.2015 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne Republiken e Shqiperise”.
-
- Ne perfundim te ketij Raport Perfundimtar Kontrolli rezultojne keto detyrime per subjektin:
- Ulje Teprice kreditore ne Tvsh =6257350 leke;
- Gjore per Tvsh-ne =6254458 leke;
- Tatim fitimi per te paguar =3774476 leke;
- Gjore per tatim fitimin = 4692523 leke;
- Gjore per leshim fature te pasakta = 100000 leke;
-
- TOTALI I DETYRIMIT = 21078807 leke.

Vlerësimi i Gjykatës:

Në lidhje me këtë kërkim, gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkeses dhe shfuqizimin e akteve objekt gjykimi, kolegji vlerëson se ky perfundim i gjykates eshte rrjedhoje e analizës së drejtë të provave dhe ligjit, gjykata i ka dhënë _përgjigje pretendimeve te paleve ne proces, per rrjedhoje shkaqet e ngritura ne ankim prej pales se paditur nuk qëndrojnë dhe nuk determinojne ndryshimin e vendirnit, si i tillë ai në këtë pikë duhet të lihet në fuqi duke argumentuar si më poshtë:

Shoqëria ka deklaruar se fitot janë në masën 19%-20% për pasojë lënda e parë ka shërbyer për prodhimin e produktit për shitje ka një firo në masën respektive e cila, nga ana e palës së paditur duke mos u njohur është rivlerësuar si produkt e për pasojë është llogaritur edhe vlera e TVSH-se e cila jo vetëm që nuk është konsideruar TVSH e kreditueshme por është llogaritur si detyrim e për pasojë shoqëria është gjobitur në të njëjtën vlerë.

Duke ju referuar përsëri pikës 4 të VKM-së nr. 434/2015 kjo është e pamundur ligjërisht të zbatohet nga paditësi pasi nuk egziston asnjë institucion i njohur ligjërisht që të certifikojë kartën teknologjike për produktet plastike e copëtuar dhe produkte pelet druri. Në VKM-në janë percaktuar disa institucione për certifikimin e kartes teknologjike, por për rastin e mesipërmë nuk ka asnjë organ të percaktuar. Duke ju referuar VKM-së se percaktimi i tyre do të bëhet referuar llogaritjes së vet subjektit dhe procesverbalit që hartohet e nënshkruhet nga inspektori tatimor.

Nisur nga natyra e shkëljes, gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me një akt relativisht të pavlefshëm.

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1471, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Rrëzimin e Kërkesë Padisë.

10. Vendim nr. 3352, datë 23.12.2019**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

Paditës: Shoqëria “D.F” sh.p.k me Nipt _____

I Paditur: 1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

2. Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë

Objekti:

1. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ vendimit nr. _____ prot, datë 16.12.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor
2. Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ prot, datë 25.08.2015, si të bazuar në ligj.

Shuma e detyrimit tatimore: 2,000,000 lekë

BazaLigjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar përaktësisht Neni 108 pika 5, Neni 119, pika 1 gërma (a), neni 122, pika 1 gërma (b,i);
2. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 80.3 (c); pika 108.5; 119/1 gërma (a), neni 122, pika 1 gërma (b,i);
3. Ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Detyrueshme të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” Neni 11 pika 3 e Udhëzimit nr. 23 të MF në zbatim të këtij ligji, pika 4.1.
4. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
5. Kodi i Procedurave Administrative.

Përmbledhje e Fakteve:

Ndaj subjektit “D.F” sh.p.k me Nipt ____ Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, pranë DRT në bashkëpunim me Policinë e Qarkut Vlorë kanë ushtruar një kontroll në ambientet e subjektit në bazë të Urdhërit të Punës me nr. ____ prot, datë 14.08.2015. Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërinë “D.F” sh.p.k është mbajtur Akt-Konstatimi me nr.serial ____ datë 14.08.2015 ku rezultoi se: *“...subjekti është i regjistruar në QKR, është i pajisur me kasë fiskale por nuk lëshon kupon tatimorë për cdo shitje të bërë për të pasqyruar qarkullimin e realizuar të mallrave e shërbimeve. Në momentin e kontrollit në punë u gjetën këta punonjës: ____, ____, ____, ____, _____. Ora e kontrollit 13:00 ...”*

Akt konstatimi i mbajtur është përcjell për procedura të mëtejshme në DRT Vlorë, inspektori i dosjes ka bërë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të konstatimit të mbajtur është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobë me nr. serial, ____ datë 14.08.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 119, pika 1 gërma (a), subjekti është penalizuar me gjobë në masën $4 \times 500.000 = 2.000.000$ lekë për katër punonjës të padeklaruar në organet tatimore përkatësisht punonjësit ____, ____, ____ dhe ____, të cilët janë deklaruar si punonjës nga ana e subjektit ditën e ushtrimit të kontrollit, në datën 14.08.2015 vërtetuar kjo e fundit me anë të formularit të deklarimit ESIG 027 “Deklarata e të punësuarëve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr. 19, datë 14.08.2015 dhe kryenin punë rregullisht”.

Për këto penalitete subjekti është njoftuar nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. ____ Prot, datë 25.08.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata ka vlerësuar se procesi gjyqësor dhe dhënia e vendimit përfundimtar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është themeluar saktë në fakt dhe në të drejtë me arsyetimin si më poshtë:

Inspektorët e kontrollit në terren të Drejtorisë rajonale Vlorë kanë konstatuar teksta punonin pranë palës paditëse pesë shtetas që nuk ishin të deklaruar në organin tatimor, të paktën një ditë përpara fillimit të punës. Këtë fakt, personat e ngarkuar nga ligji me këtë kompetencë e kanë dokumentuar në aktin e konstatimit të datës 14.08.2015. Ky i fundit përbën provë të plotë për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, në kuptim të nenit 253 të K.Pr.Civile.

Rrjedhimisht edhe fakti i konstatuar nga inspektorët tatimorë që pesë persona u gjetën duke punuar në ambientet e personit fizik, shoqëria “D.F” sh.p.k, është provuar plotësisht nga akti zyrtar i përpiluar nga nëpunësit e shtetit, brenda dhe në ushtrim të kompetencës së tyre, dokumentuar në aktin e konstatimit, të përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit për procedurat tatimore. Këtu duhet të vëmë në dukje se, akti i konstatimit është nënshkruar edhe nga z. ____, si përfaqësues i administratorit të shoqërisë dhe në të nuk është pasqyruar asnjë vërejtje në lidhje me konstatimin e bërë.

Ndodhur në këto kushte, pala paditëse, shoqëria "D.F" sh.p.k, nëse donte të provonte të kundërtën e fakteve të provuara nga inspektorët tatimorë, ajo duhet të pretendonte falsitetin e këtij akti zyrtar me fuqi të plotë provuese. Pala paditëse nuk ka zgjedhur rrugën e parashikuar nga ligji për të vërtetuar të kundërtën e fakteve të provuara në përputhje me ligjin procedural civil nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë. Ajo ka pretenduar se këta shtetas, përvec z.____, që e pranon që është punonjës i saj, nuk ishin duke punuar për llogari të shoqërisë, por po interesoheshin të fillonin punë. Ky fakt mbeti i paprovuar në gjykim dhe bie në kundërshtim me rrethanat e vërtetuara me aktin e konstatimit. Kolegji vë në dukje se, si ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", ashtu edhe ligji nr. 9920/2008, kërkon që deklarimi i punonjësve të bëhet në organet tatimore. Madje neni 119 i ligjit nr.9920/2008, kërkon që deklarimi të bëhet të paktën një ditë përpara fillimit të punës së punonjësit. Ndryshe nga sa pretendon në ankim paditësi, ai ka qenë i detyruar që përpara se të punësonte këta persona duhej që të paktën një ditë përpara t'i kishte deklaruar në organet tatimore, fakt që nuk ka ndodhur.

Gjykata ka arsyetuar se, pretendimet e palës paditëse, se këto persona nuk ishin të punësuar prej saj, mbeten të paprovuara në gjykim, në kuptim të neneve 8 e 12 të K.Pr.Civile. Kolegji thekson se, gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore (nenet 10 dhe 20/2 të K.Pr.Civile) e mbështet vendimin e saj vetëm në faktet që i rezultojnë gjatë gjykimit. Në rastin në gjykim, pala e paditur, DRT Vlorë, në përputhje me barrën e provës, të sanksionuar në nenin 35(2) të ligjit nr. 49/2012, ka provuar në gjykim faktin se tatimpaguesi, shoqëria "D.F" sh.p.k, në datën 14.08.2015, ditën e ushtrimit të kontrollit nga inspektorët e palës së paditur, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, kishte punësuar pesë persona, të cilët të paktën një ditë përpara fillimit të punës nuk i kishte deklaruar në organin tatimor dhe as i paguante sigurimit e detyrueshme shoqërore e shëndetësore.

Këtë detyrim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ia ka njoftuar palës paditëse, nëpërmjet vlerësimit tatimor nr. __prot., datë 25.08.2015, me të cilin e njoftonte paditësin se duhet të paguante shumën prej 2,000,000 lekë, si dënimin administrativ me gjobë, për punësimin e pesë personave të pasiguruar. Në pasojë, edhe vendimi i Drejtorinë e Apelimit Tatimor, nr. __ prot., datë 16.12.2015, në pjesën që ka lënë në fuqi këtë dënim administrativ, është i themeltë në të drejtë dhe në fakt, për sa kohë u konkludua se i tillë ishte edhe njoftim vlerësimi tatimor, në këtë pjesë. Ky kolegji thekson se, kjo sjellje e tatimpaguesit është e kundërligjshme dhe e sanksionueshme me gjobë në masën 500,000 lekë për cdo punonjës, sipas nenit 119, të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar (në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes administrative tatimore).

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 528, datë 13.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Rrëzimin e Kërkesë Padisë.

11. Vendim nr. 146 date 29.01.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Padites: A

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Objekti: Shfuqizimin e njoftim vlerësimit tatimor nr. _____, datë 14.04.2017 dhe njoftim vlerësimi nr. _____, datë 26.04.2017.

Shuma e detyrimit tatimor: 878.675 lekë TVSH

Baza Ligjore:

1. Kodi i procedurës Civile, nenet 31, 32, 154
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Permbledhje e Fakteve

Nga Drejtoria e Vleresimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit në datën 03.03.2017 është mbajtur proces verbali në lidhje me verifikimin e librave të shitjes, konkretisht deklarimin e shitjeve të kryera nga ana e subjektit. Subjekti ka kryer shitje me pakicë në individë konsumatore të cilat i ka regjistruar në librat e shitjes si kliente me kase fiskale fugon, ndërkohe që shitjet e kryera nga NIPT-I sekondar i furgonit janë të përcaktuara si shitje derë me derë dhe jo shitje me pakicë. Mbi llogaritjet e bërë në këtë process verbal është nxjerrë akti administrative njoftim vlerësimi tatimor nr. _____ prot date 14.04.2017 me gjobë TVSH 878.675 leke.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata në përfundim të gjykimit vendosi rrëzimin e padise, gjykata ka vleresuar se ne rastin konkret njoftim vlerësimi per detyrimet tatimore ploteson kriteret e nenit 69 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe se aktet objekt gjykimi nuk përmbajnë asnjë element që të perbeje cënimin e formës dhe procedurës në nxjerrjen e tyre. Kolegji ka çmuar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë, subjekti nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 59.2 të ligjit br. 9920 date 19.05.2008, pasi nga furgoni që është vend vetëm për shitje me shumice, paditesi ne fakt ka shitur në individë konsumatore final me kupon tatimor, vërtetuar nga të dhënat e kasës fiskale

Vendim:

1. Rrëzimi i kerkesë padisë.